



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 47.
Prishtinë, më 24.08.2012 në ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, ,
Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic, Rasim Demiri dhe Xhevdet Neziraj

Munguan: Elmi Reçica, Glauk Konjufca dhe Mufera Sinik

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësuesja nga OSB, Lejla Selimi, përfaqësues nga zyra e KDI-së Nevahir Hazeri, përfaqësues nga zyra – EU Pleurat Kurti, përfaqësues nga zyra e OSB-së Jeton Bytyqi, Bekim Kodraliu, përfaqësuesi nga zyra e Presidencës (ZPRK) Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, zyrtare e lartë ligjore, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Goran Marinkovic**, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të kaluara.
3. Miratimi i procesverbalit nga takimi i Dëgjimit Publik, të datës 19.06.2012
4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-126 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-099 për Letërnjoftimin, me raportin e komisionit Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me amendamente
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-124 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-203 për Metrologji, me raportin e komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, me amendamente
6. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore, me raportin e komisionit Funkcional për Legjislacion, me amendamente

Kryesuesi – konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, njëherit hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Kryesuesi -konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur me 27.06.2012, 11.07.2012, pa vërejtje.

3. Miratimi i procesverbalit nga takimi i Dëgjimit Publik, të datës 19.06.2012

Kryesuesi - konstatoi se gjithashtu komisioni miratoi procesverbalin e Dëgjimit Publik të datës 19.06.2012, pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-126 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-099 për Letërnjoftimin, me raportin e komisionit Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin Nr. 04/L-126 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-099 për Letërnjoftimin të propozuara nga Komisioni funksional i cili ka paraqit raportin me dy amendamente, andaj kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim tjetër, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohet Komisionit Funkcional.

Albert Kinolli – me theks të veçantë tha se GP 6+ ka zbatuar procedurat e parashikuara me Rregulloren e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës , dhe se me datën 5.07.2012 i ka proceduar propozim amendamentet në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Në këtë drejtim, komisionit Funkcional nuk ka dhënë përgjigje me shkrim, lidhur me realizimin e procedimit të amendamentit të GP 6+. Në këtë kontekst ai kërkoi që të njëjtat të shqyrtohen në komisionin për komunitet ku do të dalim me rekomandim i cili do t dorëzohet për shqyrtim komisionit Funkcional.

Ai tha se qëllimi i propozim amendamentit të GP 6+ janë, të fshihet neni 4 i propozuar nga komisioni funksional nga se neni 4 i projektligjit në fuqi është më i kompletuar dhe i njëjti mbron të drejtat dhe interesat e komuniteteve .

Propozimi i tij ishte që komisioni janë sot ti shqyrtoj amendamentin e GP 6+ dhe i njëjti të hedhet në votim për miratimin apo mos miratimin e tij.

Kryesuesi – ajo që konsiderohet mjaft e rëndësishme është se problemi qëndron se komisioni funksional nuk i ka proceduar amendamentet e GP 6+ në komisionin tanë. Mirëpo nëse ka vullnet të përbashkët nuk është arsye që sot të njëjtat të mos shqyrtohen në komision

Xhevdet Neziraj – tha se mos procedimi i amendamentit të GP 6+ në komisionin tonë është bar e komisionin funksional . Mendon se zgjidhja më e mirë është që të marrim raportin e komisionit funksional, të verifikohet si janë deklaruar më pas komisioni do të dal me rekomandim konkret.

Petar Miletic- tha se propozim amendamenti i GP 6+ është në kundërshtim me propozim raportin e komisionit funksional sepse proceduralish nuk mundë të votohen dy propozime për të njëjtën çështje. Njëherit, respekton kërkesën e z, Konolli që propozimi i tyre të procedohet për votim.

Mirëpo ajo që konsiderohet problematike është se amendamentet e GP 6+ janë proceduar vetëm në komisionin Funkcional. Andaj është i mendimit që propozim amendamenti i GP 6+ të shpërndahet edhe anëtarëve të komisionit tanë, ku krahas vlerësimit do të dalim me qëndrime konkrete. Pas dilemave të shumta ai konsideron që komisioni të votoj amendamentet e komisionit Funkcional ose kjo pikë të shtyhet deri sa të merret raporti final nga komisioni funksional ku krahas vlerësimit të përgjithshëm do të ofrohen sugjerimet tona konkrete.

Kryesuesi – në bazë të diskutimeve të shumta ai propozoi që komisioni të votojë amendamentet e komisionit Funkcional. Ndërsa në mbledhjen e ardhshme do të marrim raportin nga Komisioni Funkcional, ku do të informohemi lidhur me vlerësimin e amendamentit të GP 6+.

Lumije Morina – ajo u shpreh se në bazë të procedurave të Rregullores së punës së Kuvendit, secili grup parlamentar apo secili deputet individualisht ka të drejtë që gjatë shqyrtimit të projektligjeve të hartoj amendamente dhe ti dërgoj komisionit funksional.

Ishte e mendimit se komisioni duhet të përcaktohet për votimin e amendamentit të GP 6+.

Njëherit pajtohet me propozimin e z. Petrovic, dhe shtoi se komisioni Funkcional është i obliguar që pas shqyrtimit të amendamentit të propozuar të GP 6+, dhe se raporti final të dërgohet në komisionet e përhershme, me apo pa përkrahje.

Propozimi i saj ishte që fillimisht të marrim raportin e komisionit Funkcional lidhur me vlerësimin e këtij amendamenti, dhe më pas të procedohen në komision, ku do të dalim me qëndrimet tona konkrete.

Rasim Demir – në fjalën e tij tha se ishte për vizitë në Bruksel, në periudhën kur është dorëzuar amendamenti i GP 6+ dhe se i njëjti nuk ka marr përkrahjen nga komisioni Funkcional.

Kërkesa e tij ishte që kjo pikë të shtyhet për ditën e hënë, nga se do të mbahet mbledhja e komisionit Funkcional ku do të merren informata lidhur me përfundimin e raportit final.

Kryesuesi – konstatoi se u mur qëndrim se mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve do të mbahet ditën e hënë me 27.08.2012 në ora 10.00, ku do të shqyrtohen dy propozimet, të komisionit Funkcional dhe propozimi i amendamentit të GP 6+, dhe se do të dalim me rekomandim i cili do të dërgohet Komisionit Funkcional.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-124 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-203 për Metrologji, me raportin e komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, me amendamente.

Komisioni shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-124 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-203 për Metrologji dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim njëzëri, nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-124 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-203 për Metrologji dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore, me raportin e komisionit Funkcional për Legjislacion, me amendamente.

Komisioni shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim njëzëri, nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

7. Të ndryshme.

Kryesuesi, në fjalinë e tij se për realizimin e Planit të veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Integritet Evropian, për tremujorin e dytë 2012, ka mbet si sfidë e Komisionit realizimi i vizitës në terren të komunitetit Romë Ashkali dhe Egjiptian në zonën e Mitrovicës ku në këtë zonë niveli i kontaminimit me plumb është i lartë si dhe çështja e mbulimit me vaksinim për komunitetet pakicë.

Kryesuesi konsideron se në periudhën e afërt, komisioni do të realizon vizitën në terren, në pjesën veriore të zonës së Mitrovicës, që të verifikohet niveli i kontaminimit me plumb si dhe mbulimi me vaksinim të plotë të komunitetit Romë Ashkali dhe Egjiptian.

Gjithashtu konstatoi se në mbledhjen e radhës, komisioni do të bëjë ftesë përfaqësuesit të Ministrisë së Shëndetësisë, që të ofrojnë informata lidhur me kontrollin dhe trajtimin nga kontaminimi me plumb dhe gjendjen shëndetësore që prekin jetën e komunitetit pakicë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

**Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic